



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 1377/23 Datë: 06.10.2023

Në mbështetje të nenit 8 dhe 12 të Ligjit për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura të Republikës së Kosovës Nr.06/L-113 (GZ, Nr.07/01 mars 2019), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr. 05/L-031 (GZ, Nr.20/12 Qershor 2016), Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), dhe Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, (përditësuar me vendimin Ref.932/22), Këshilli Shtetëror i Cilësisë (tutje KShC), në mbledhjen e 115-të, të mbajtur me datë 25.08.2023, mori:

V E N D I M

- I. Akreditohet programi i studimit të Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sportit të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, për periudhën tre (3) vjeçare, (1 tetor 2023 – 30 shtator 2026):
 - *Edukim Fizik dhe Sport MA*, 60 ECTS, me kuotën, maksimum 25 studentë për vit akademik.
- II. Numri i përcaktuar i studentëve aplikohet për të gjitha vitet e studimit për periudhën e akreditimit.
- III. Obligohet Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sportit të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” që deri më datë 15.11.2023 të dorëzojë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- IV. Obligohet Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sportit të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, të raportojë dhe arsyetojë çdo ndryshim në listën e bartësve të programit të studimit në AKA, brenda 90 ditëve. Lista e përditësuar e bartësve aprovet nga KShC.
- V. AKA rezervon të drejtën e aplikimit të dispozitave të nenit 21 të Udhëzimin Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, kurdo që vlerëson të arsyeshme dhe të nevojshme.
- VI. Institucioni i Arsimit të Lartë si në pikën I, mbanë përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkallim të këtij vendimi.
- VII. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sportit të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (tutje AKA) për akreditimin e programit të studimit me stafin akademik si në tabelë:

<i>Nr.</i>	<i>Programi i studimit</i>	<i>Bartësit e programit</i>
1	<i>Edukim Fizik dhe Sport MA, 60 ECTS, Akreditim</i>	Besim Halilaj

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA me datë 27.02.2023 ka organizuar vizitë me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Fakultetin e Edukimit Fizik dhe Sportit të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” për programin, me këtë përbërje: Chris Richter dhe Marija Vasilevska.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, Ekipi i Vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit, dhe për secilin program, dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

1. Për programin e studimit *Edukim Fizik dhe Sport MA, 60 ECTS, Akreditim*, nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: substancialisht pesë (5) dhe pjesërisht dy (2) standarde.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e 115-të, të mbajtur me datë 25.08.2023 ka shqyrtuar aplikacionin/kërkesën e Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sportit të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave, si dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Ndaj këtij vendimi pala mund të parashtrroj ankesë sipas Ligjit Nr.05/L-031 mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative në organin që ka nxjerrë këtë vendim, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar. Inicimi i konfliktit administrativ apo çfarëdo procedure tjetër administrative nuk e pengon ekzekutimin e këtij vendimi.*

Vendimi iu dërgohet:

- UP – Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sportit;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së,


Prof. Asoc. Dr. Mashija Ilazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë


Affiliate
of **ENQA**.